

**PROGRAMI I TRAJNIMIT PËR MËSUES,
PËR IMPLEMENTIMIN E PROJEKTIT “SHAHU NE SHKOLLA”**

Lloji i trajnimit: Trajnim i drejtpërdrejtë

Programi i trajnimit “ Implementimi i Projektit Shahu në Shkolla” përfshin tematikat:

- 1: Koncepti për Shahun në shkolla si mjet edukativ.
- 2: Metodologjia e mësimdhënies së shahut bazuar në librin e mësuesit.
- 3: Vlerësimi i arritjeve të nxënësve bazuar në librin e nxënësit.
- 4: Orientimi i nxënësve për regjistrim në paketat e fide sm dhe psm.
- 5: Modele të organizimit të projekteve të përbashkëta ndërlendore dhe i grupeve e klasave të shahut në shkollë.
- 6: Modele të organizimit të aktivitete shahistike të propozuara si “Dita/ët e Shahut ne shkolla”, “Dita e shahut në rrugë”, për përfshirjen e më tejshme të nxënësve në klubet e shahut.

Te paraqitura sipas tabelës më poshtë:

Tematika	Numri i orëve (per t u ripare)
Koncepti për Shahun ne shkolla si mjet edukativ	2 orë
Metodologjia e mësimdhënies se shahut bazuar në librin e mesuesit	2 orë
Vlerësimi i arritjeve të nxënësve bazuar ne librin e nxenesit “	2 orë
Orientimi i nxënësve për regjistrim në paketat e fide sm dhe psm	2 orë
Modele të organizimit të projekteve të përbashkëta ndërlendore dhe i grupeve e klasave të shahut në shkollë.	2 orë
Modele të organizimit të aktivitete shahistike të propozuara si “Dita/ët e Shahut në shkolla”, “Dita e shahut në rrugë”, për përfshirjen e më tejshme të nxënësve në klubet e shahut.	2 orë
TOTAL	12 orë

Përfituesit e trajnimit

Përfituesit nga realizimi i këtij programi trajnimi janë:

- mësues të shkollave të përfshira në projekt, në qytete të ndryshme
- specialistë të FSHSH- të licencuar, instruktorë të shahut në shkolla.

Organizatorë : FSHSH; MAS; KOKSH; DAR

Metodologjia e trajnimit

Rubrika e metodologjisë së zbatimit të këtij moduli, përmban metodat që do të përdoren për secilën seancë të trajnimit, mjetet mësimore për konkretizim dhe detyrat për pjesëmarrësit që do të kryhen pas zhvillimit të modulit. Ky informacion është organizuar në tabelën më poshtë:

Tema	Metoda	Mjetet
Seanca 1		
Shahu në shkolla si mjet edukativ	<i>Prezantim nga trajneri i projektit të shahut në shkolla dhe menyrave të implementimit në shkolla</i>	Bimer, Lap top, Prezantimi në PPT
	<i>Prezantim nga trajneri i elementeve të programit të trajnimit duke nxitur diskutimet me pjesëmarrësit.</i>	
Seanca 2		
Metodologjia e mësimdhënies së shahut bazuar në librin e mësuesit	<i>Prezantim nga trajneri mbi përmbajtjen e lendes dhe menyra e dhenies së njohurive dhe koncepteve</i>	Bimer, Lap top, Prezantimi në PPT Fushe shahu
	<i>Punë në grup:</i> Pjesëmarrësit ndahen në grupe. Secili grup përcakton sipas mënyrës së tij përmbajtjen e tematikave, menyrën e dhenies së njohurive, në pershtatje me grup moshat e nxenesve	Libri i shahut për mësuesin Komplete shahu
	<i>Pjesëmarrësit prezantojnë, diskutojnë, komentojnë dhe nxjerrin përfundime.</i>	Fletore, Stilolaps, Flipçart, Lapustila,
Seanca 3		
Zbërthimi i rezultateve të nxënësve bazuar në librin e nxënësit	<i>Prezantim nga trajneri për rezultatet e të nxënit (njohuritë) për secilën</i>	Libri i nxenesit

	tematikë	
	<i>Diskutime me pjesëmarrësit</i> mbi rezultatet e të nxënit, të cilat zbërthehen sipas klasave.	Libri i nxenesit
Seanca 4		
Regjistrimi në paketat e fide sm dhe psm	Prezantimi nga trajneri Punë në grup: Pjesëmarrësit ndahen në grupe dhe secili grup provon fazat e regjistrimit	Materiali spjegues i printuar Kompiutera , internet
	Pjesëmarrësit prezantojnë, diskutojnë, komentojnë dhe nxjerrin përfundime.	Fletore, Stilolaps, Flipçart, Lapustila.
Seanca 5		
Modele organizimi të projekteve të përbashkëta ndërlëndore dhe i grupeve e klasave të shahut në shkollë	Prezantim nga trajneri Formatet e planifikimit të projektit Propozime per	Bimer, Lap top, Prezantimi në PPT
	Punë në grup përgatitja e një projekti të shkolles Përgatitja e një projekti të klases Përgatitja e një tabele krahasuese me ndryshimet dhe vecoritë e një projekti të shkolles dhe të klases.	Fletore, Stilolaps, Flipçart, Lapustila, Fletë pune tabela krahasuese
Seanca 6		
Modele të përgatitjessë një aktiviteti të shahut: “Dita / et e shahut në shkolla” “Shahu në rrugë”	Ushtrim: Punë në grupe për hartimin e planifikimit të një aktiviteti të klasës dhe të shkollës .	Fletore, Stilolaps, Flipçart, Lapustila. Fletë pune për formatet e planifikimit
	Pjesëmarrësit prezantojnë, diskutojnë dhe nxjerrin përfundime.	Fletore, Stilolaps, Flipçart, Lapustila.

Trajnues:-----

I. Përshkrimi i përmbajtjes

Shahu si sport i mendjes, në këndvështrimin tonë të përbashket, është një sport i cili do të futet në shkollë si mjet edukativ dhe do të ndihmojë nxënësit jo vetëm për zënie aktive të kohës së lire, por gjithashtu do të shërbejë në strukturimin e ditëve në tërësi, aftësisë për gjetjen e zgjidhjeve më të përshtatshme në kohën e duhur etj..

Në shkollë, ai do të aplikohet në kuadrin e programit edukativ, duke ndërthurur, marrjen e njohurive shahistike elementare nëpërmjet projekteve të përbashkëta ndërkombëtare, krijimin e grupeve të shahut dhe pjesëmarrjen në garat e shkollës, si dhe regjistrimin në paketat e programit Chess in school si dhe psm.

Jashtë shkollës, gama e gjerë e njohurive shahistike të ofruara nga paketat e mësipërme, i lejon secilit nxënës të zbulojë dhe të praktikojë një shumëllojshmëri mundësish për të shfrytëzuar bibliotekën shahistike online, në varësi të moshës dhe të nivelit personal, të zhvillojë aftësitë personale për pjesëmarrjen në gara, si dhe të zbulojë një mënyrë më frytdhënëse dhe të dobishme, të përdorimit të lojrave kompjuterike.

Më tej, ata që do të jenë të interesuar, do të mund t'i zhvillojnë njohuritë e tyre nëpërmjet pjesëmarrjes në grupet sportive të shkollës dhe përfaqësimet në garat ndërkombëtare dhe me njohuri më të thelluara, duke u përfshirë në grupet sportive të klubeve sportive.

Qëllimi i Përgjithshëm: Shahu në shkollë si mjet i kulturës dhe edukimit “Për më shumë njerëz inteligjentë”

Qëllimet specifike- objektivat: Shahu ndihmon në zhvillimin e:

Aftësi njohëse: si vëmendja, kujtesa, të menduarit logjik, rrit përqëndrimin, memorjen, inteligjencën

Aftësi thelbësore për zhvillimin e individit: Kreativiteti, nëpërmjet zgjidhjeve të problemeve; të menduarit kritik; aftësia për të vlerësuar pikat e forta dhe të dobëta; gjykimi i vlerave; marrja e vendimeve; mromovimi i përdorimit të dobishëm të teknologjisë.

Sensitivitet; përmirësimet në qëndrimet dhe sjelljen e përgjithshme,

Shahu inkurajon vetëvlerësimin, konkurrencën e shëndetshme, punën në grup, studimin e vazhdueshëm si një rrugë për të arritur objektivat dhe ka për qëllim përmirësimin personal.

Rrit ndjeshëm performancën në mësimet. Shahu shërben për të strukturuar kohën e lirë të fëmijës.

Benefite specifike:

Përqëndrimi: Fëmijët zhvillojnë aftësinë e vëzhgimit të kujdesshëm dhe përqëndrimin. Nëse ata nuk shikojnë dhe kuptojnë se çfarë po ndodh, ata nuk mund të reagojnë, pavarësisht se sa të zgjuar janë.

- **Përfytyrimi:** Fëmijët janë të prirur për të imagjinuar sekuencën e veprimeve përpara se ato të ndodhin. Shahu zhvillon aftësinë e kujtesës nëpërmjet trajnimit për të

zhvendosur gurët në mendjen e tyre, duke filluar nga një lëvizje , per te kaluar më pas në disa lëvizje

- **Të menduarit e llogjikshëm:**Fëmijët mësojnë të mendojnë përpara se të veprojnë. Ata mesojne të pyesin veten "Nëse e bëj këtë, çfarë mund të ndodhë më pas, dhe si mund të përgjigjem? Me kalimin e kohës, shahu ndihmon zhvillimin edurimit dhetë menduarit e llogjikshëm.
- **Vlerësimi i opsioneve/ alternativave:** Fëmijët mësojnë të mos veprojnë instiktivisht, por të identifikojnë alternativat dhe të marrin parasysh të mirat dhe të këqijat e veprimeve të ndryshme.
- **Analiza konkrete:** Fëmijët mësojnë të vlerësojnë rezultatete veprimeve dhe sekuencave evecanta, duke gjykuar nëse është e vlefshme apo jo.
- **Të menduarit abstrakt:** Fëmijët mësohen t'u rikthehen detajet dhe t'i rivlerësojnë në mënyrë periodike duke ikonsideruar atonë tërësine e tyre. Ata gjithashtu mësojnë modele të caktuara për t'i përdorur dhe zbatuar në lidhje me kontekstet dhe situatat e ndryshme.
- **Planifikimi:** Fëmijët aftësohen të zhvillojnë qëllime afatgjata dhe të ndërmarin një varg veprimesh drejt realizimit të tyre, si dhe të rivlerësojnë planin e tyre, në lidhje me situatat dhe zhvillimet e reja.
- **Aftësia për të ndërtuar strategji:**Fëmijët inkurajohen nëpërpjekjet për të vlerësuar njëkohësisht faktorë të ndryshëm.

"Shahu kontribuon në zhvillimin e të menduarit strategjik, përqendrimin, aftësitë analitike dhe zgjidhjen e problemeve."

A. Shahu nëshkolla si mjet edukativ:

Sfida kryesore për fëmijët duhet të jetë eksplorimi dhe zhvillimi i mënyrës së të menduarit

Mësuesit dhe edukatorët kanë nevojë për një mënyrë të drejtpërdrejtë në procesin e mësimdhënies me standarte(aftësa e të menduarit).

Në kushtet e mbingarkesës së programeve mësimore, është e rëndësishme që përmbajtja e programit të mësimave të shahut të mos shtrihet çdo ditë.

Sfida kryesore për fëmijët duhet të jetë zbulimi dhe zhvillimi i rruges dhe mënyrës se si ne mendojmë. Do të ishte ideale, nëse arrihet që ajo të bëhet në mënyrë argëtuese.

B. Shahu në shkollë si mjet mësimor:

Shahu i ka të gjitha cilësitë për të qënë një mjet i shkëlqyer mësimor. Për një përfitim maksimal prej tij, shahu do të duhet të futet në shkolla, jo për të zhvilluar lojtarët e shahut, por për të rritur më shumë zhvillimin e fëmijëve.Shahu mund të përdoret për të zgjidhur problemet edukative, vecanërisht në procesin e mësimdhënies me standarte, **"aftësitë e të menduarit"** *Shahu, i përdorur jo për hir të të mësuarit të shahut, jo për të krijuar shahistë më të mirë, por për të ndihmuar që shkollat të nxjerrin më shumë nxënës inteligjentë, më të adaptuar me njohuritë bazë për botën, një të ardhme më të shkëlqyer për shoqërinë tonë.*

Projekti i shahut ne shkolla do të implementohet nëpërmjet:

1. Regjistrimi on line në paketat "Fide chess in school " (Mësuesit e informatikës).
2. Organizimi i projekteve të përbashkëta ndërlëndore dhe *grupeve e klasave të shahut në shkollë për mësimet e shahut mbështetur në librin e mësuesit dhe të nxënësit*
3. Aktivitete shahistike të propozuara si "Dita/ët e Shahut ne shkolla", "Dita e shahut në rrugë" me synim **përfshirjene më tej të nxënësve në klubet e shahut.**

I. Regjistrimi on-line i nxënësve në paketat "Fide Chess in School sm &psm"

- Me anë të regjistrimit në paketat sm.fide.com dhe psm.fide.com të ofruara nga Federata Botërore e Shahut, nxënësit do të mund të ndërthurin njohuritë në gjuhët e huaja, meqëse këto paketa ofrohen në disa gjuhe të ndryshme; do të zhvillojnë aftësitë në përdorimin e kompiuterit; do të përdorin kohën e lirë në kompiuter në mënyrë të dobishme me zhvillimin e njohurive shahistike dhe lojrave të shahut.
- Paketa e parë *sm.fide.com* (anëtarësim i thjeshtë) është falas dhe ofron: hyrje në ëeb-site dhe shfrytëzimin e programit të shahut në shkollë.
- Paketa e dytë *psm.fide.com* (anëtarësimi premium), i cili është me një pagesë prej 10€ për anëtarësim dhe ofron: shfrytëzimin e bibliotekës on-line dhe metodave për mësimin e shahut, anëtarësim në FIDE dhe FSHSH, marrjen e kartës ID të anëtarësimit, si dhe mundësimin e rankimit (listimit) ndërkombëtar sipas rrezultateve individuale.

🚩 Procesi organizativ dhe edukativ

Organizimi në grup, për të realizuar projektin e regjistrimit on-line të nxënësve në paketat Fide Chess in School sm & psm kërkon: dhenie të njohurive, bashkëpunim me nxënësit e prindërit si dhe me mësuesit e informatikes (aty ku ekzistojnë klasat e kompiuterit në shkollë), respektim të dëshirës dhe vullnetit të tyre, vëmendje dhe angazhim nga ana e mësuesve kordinatorë të shkollave, përpikmëri në dhënien e informacionit dhe përkujdesje për kryerjen e plotë të procesit, punë të pavarur nga ana e nxënësve të interesuar. Motoja e një procesi të tillë është ajo e Fide dhe FSHSH, "Jemi një Familje e Madhe " dhe "Për më shumë njerëz të zgjuar"

Njohja paraprake e grupit të nxënësve, potencialet e tyre dhe dëshira për t'u përfshirë në një proces të tillë, duhet të bëhet duke dhënë informacionin e duhur në lidhje me mundësitë dhe përfitimet personale e të grupit, për zhvillimin e një projekti kolektiv.

✓ Organizimi

- Programohet takimi me nxënësit e klasave të ndryshme, për dhënien e informacionit të duhur.

- Njihen nxënësit me paketat e regjistrimit dhe mundësitë që ato ofrojnë, si dhe me përfitimet nga secila prej tyre.
- Pasi merret pëlqimi i nxënësve dhe konfirmimi i prindërve, në rastet që është e mundur në shkollë, në një aktivitet të përbashkët me mësuesin e informatikës, kryhet procesi i regjistrimit
- Në rastet që shkollë nuk e ka mundësinë e klasës së kompjuterave, jepen njohuritë e duhura për nxënësit, nga kordinatori i aktivitetit.

✓ **Burime:**

- Për organizimin e regjistrimit: sigurohet vënia në dispozicion e klasës së informatikës e pajisur me kompjuter dhe internet.
- Në shkollë: mësuesit e tjerë të klasës (informatika, matematika, fizika, aftesimi teknologjik etj.)
- Jashtë shkolle, qendrat e internetit apo kompjuteri personal.
- web I Fide: <https://www.fide.com/>
- web dhe fb. I FSHSH. (faqja ne ndertim www.achf.org.al)

✓ **Zhvillimi:**

○ **Para regjistrimit**

- Njoftohen te gjithë nxënësit e shkollës, duke filluar nga klasat e 2-ta dhe të 3-ta të ciklit elementar, për ekzistencën e paketave dhe mundësisë së regjistrimit, si dhe përfitimet nga secila prej tyre. Duhet të krijohen grupet e nxënësve që janë të interesuar.
- Paraprakisht janë marë të dhënat e duhura nga bashkëpunimi i mësuesit kordinator me Federatën.
- Përgatitet platforma e regjistrimit dhe përgatitet një tabelë me emrat dhe të dhënat e nxënësve të interesuar për regjistrimin me paketën sm dhe psm që i dërgohet federatës për nxjerrjen e Fide ID.
- Pas marrjes së Fide ID, në bashkëpunim me një mësues të informatikës, përgatitet një tabelë treguese me hapat që duhen ndjekur për regjistrimin e secilit nxënës

○ **Gjatë regjistrimit**

- Realizohet regjistrimi i nxënësve në grup, në klasën e informatikës/ sallën e kompjuterave, apo në mënyrë individuale nga secili nxënës në kompjuterin e vet apo qendër interneti, pasi kanë marë të dhënat nga tabela e përgatitur paraprakisht dhe janë informuar mbi hapat që duhet të ndiqen.

➤ **Hapat per regjistrimin ne paketat e “Fide Chess in school student membership, Sm dhe Psm”**

1. Hyrje ne linkun e Federates Boterore: <https://www.fide.com/>
2. Klikon poshte djathtas ne linkun: <http://sm.fide.com/>
3. Perzgjidhet gjuha(psh English): <http://sm.fide.com/main/lang/en>

4. Klikon djathtas ne linkun:

<http://sm.fide.com/site/regform/>; <http://psm.fide.com/site/regform/>

5. Klikon në: [Click here to sign up](#), për të përmbyllur formularin e regjistrimit!

○ **Pas regjistrimit**

- Secili nga nxënësit i pajisur me Fide ID, do të marrë nga një e-mail, nga ana e Fide, programi “Chess in school”, që më pas i lejon të punojë në mënyrë individuale në kohën e lirë.
- Organizohen orë praktike nga ana e mësuesit të informatikës apo mësuesi kordinator i programit.
- Mësimet dhe njohuritë e mara nga nxënësit, zbatohen në praktikë, të ndihmuara dhe nga mësuesi kordinator në aktivitetet praktike të shkollës, gjatë orëve të aktiviteteve.
- Mundësohet organizimi i kampionateve të shkollës dhe në mënyrë të shkallëzuar pjesmarrje në aktivitete ndërmjet shkollave organizuar nga DAR.
- Mbahet kontakt me specialistët e shahut, përgjegjës për shkollat, që do të konformohen nga bashkëpunimi me FSHSH.

✓ **Pengesa dhe vështirësi:**

- Vështirësitë që mund të hasen në procesin fillestar të regjistrimit mund të frenojnë përfshirjen e disa prej nxënësve në projekt. Por organizimi i një projekti kolektiv dhe të mirëorganizuar, me shpjegimet përkatëse, si dhe me zgjidhjen e problemeve të hasura dhe modeli origjinal i projektit të implementuar në Fide Chess in School, ka gjetur zbatimin e tij në vende të ndryshme dhe në një numër shumë të madh të shkollave, pra vënia në dijeni mbi suksesin e tij, do të kontribuojnë në motivimin e rritjes së pjesëmarrjes dhe angazhimit të tyre.
- Formimi i grupeve, si gjatë përgatitjes, ashtu dhe në procesin e regjistrimit, si dhe shpjegimet e duhura paraprake, mundësojnë përfshirjen dhe bashkëpunimin e nxënësve, që cilët më parë nuk do të kishin zgjedhur me dëshirë të bëheshin pjesë në projekt.
- Mund t’u propozohet të formojnë dyshe sipas preferencave dhe të rigrupohen më vonë në ekipe me katër veta për të mësuar procesin si dhe stërvitjen e praktikimin e mëtejshëm.
- Për pengesa dhe vështirësi në lidhje me realizimin e regjistrimit, në lidhje me detaje të ndryshme, mbahet kontakt me Federatën Shqiptare të Shahut dhe oficerin e Ratingut pranë saj **Z. Elton BABAMUSTARating Officer** ebabamusta@yahoo.com si dhe në atë të Fide, duke klikuar sipas rendit më poshtë:

✚ <https://www.fide.com/>

✚ <https://www.fide.com/component/fidedirectory/?vieë=federations>

✚ <https://www.fide.com/component/fidedirectory/?task=country&fid=3>

✚ [Rating Officer, Mr. Elton BABAMUSTA; ebabamusta@yahoo.com](mailto:ebabamusta@yahoo.com)

Kontributi edukativ i projektit:

1. Zotërimi i gjuhës së huaj

Përzgjedhja e njërës prej gjuhëve të huaja në të cilat janë sjellë paketa dhe materialet e ndryshme mbi njohuritë e shahut, do të ndihmojnë nxënësit në aftësimin e tyre të mëtejshëm në gjuhën/t e përzgjedhur.

2. Elementët e kulturës teknologjike dhe aftësisë përzgjedhëse

- Procesi i regjistrimit në njërën nga paketat si dhe procesi i zhvillimit të njohurive dhe dijeve dhe mënyra me të cilën materialet ndihmëse, pjesë e bibliotekës së Fide Chess in school janë ofruar, u japin mundësinë nxënësve të zhvillojnë aftësitë e tyre në përdorimin e teknologjisë.
- Gjetja e materialeve të përshtatshme, grumbullimi, klasifikimi dhe interpretimi i informacioneve, si dhe rrugëve të duhura për ecurinë në lojën e shahut, do të mund të zhvillojnë aftësitë për të strukturuar dijet dhe informacionet e më tej për të gjetur strategjitë e duhura në një rrugë drejt ecurisë së suksesshme.
- Përvetësimi i teknikave të përdorura të informacionit dhe të komunikimit
- Përdorimi i tabelës së regjistrimit, dhe komunikimi on-line nëpërmjet e-mailit me Fide Chess in school.

3. Kultura qytetare

Kyerja e kërkimeve për përdorimin e materialeve të ofruara nga biblioteka on line, mbi njohuritë shahistike dhe mesime on- line si dhe historinë e suksesshme të figurave të shquara në shah.

4. Kompetenca sociale dhe qytetare

Përcaktimi dhe respektimi i orareve dhe kohës së duhur për t'u marrë me lojën e shahut. Njohja e rregullave të organizimit të lojës dhe përllogaritja e veprimeve në kohën e duhur.

II. Organizimi grupeve dhe klasave të shahut në shkollë

✓ Njohuri:

- Mësimi i lëvizjeve të shahut, konceptet bazë të lojës, teknika dhe taktika, strategjitë për një lojë të mbyllur me sukses, aftësia për të parashikuar lëvizjet e mundshme të kundërshtarit.
- Përmirësimi i vetvetes nëpërmjet pjesëmarrjes në lojra dhe gara
- Të ndërtohet një plan stërvitor sipas një objektiivi e një pikësnyimi.
- Parimet e lojës së shahut, për të ndërtuar një projekt të përshtatshëm dhe të realizueshëm.

✓ **Aftësi:**

- Diferencimi i fazave të veprimit
- Aplikimi i një plani pune.
- Ndërtimi, adaptimi dhe respektimi i një projekti në funksion të aftësive të nxënësve , moshës së tyre dhe kushteve të shkollës dhe ambjentit rrethues

✓ **Sjellje:**

- Të përgatitesh për një proces të mësuarit të lojës së shahut
- Të bëhesh pjesë e një komuniteti sportiv
- Të pranosh ngarkesën e punës (studim dhe përsëritje).
- Të bashkëpunosh brenda grupit për të ndërtuar një projekt kolektiv, i cili mobilizon burimet më të mira.

III. Organizimi i aktivitetit shahistik në shkollë

Zhvillimi real dhe i qëndrueshëm i nxënësve, në sajë të praktikave të përjetuara me organizimin e grupeve dhe klasave të shahut në shkollë, aktivitetet shahistike të propozuara si kampionate apo me tej organizimi i projekteve të vecanta dhe specifike për shkollat si, “Dita/ët e Shahut” **dhe përfshirjen më tej të nxënësve në klubet e shahut.**

➤ **Procesi edukativ**

Organizimi në grup, për të realizuar projektin e organizimit të një dite shahistike në shkollë kërkon: krijimin e grupit të nxënësve të përgatitur për të marrë pjesë në garë, bashkëpunim me nxënësit dhe prindërit, bashkëpunim me mësuesit e lëndëve të tjera dhe me prindër, për organizimin e suksesshem, si dhe bazën materiale të domosdoshme, vëmendje dhe angazhim nga ana e mësuesve kordinatorë të shkollave dhe drejtuesit e shkollës, përpikmëri në ndarjen e detyrave dhe përkujdesje për organizimin e garës dhe të pjesëve përbërëse të saj.

➤ **Procesi mësimor- dhënia e njohurive**

Njohja paraprake e grupit të nxënësve, potencialet e tyre dhe dëshira për t’u përfshirë në një projekt të tillë, duhet të bëhet pasi të kemi marrë informacionin e duhur në lidhje me mundësitë dhe aftësitë individuale të nxënësve dhe të grupit, për organizimin dhe zhvillimin e një projekti kolektiv.

✓ **Organizimi**

- Programohet takimi me nxënësit që do të marrin pjesë në gara sipas grup-moshave dhe klasave përkatëse.
- Njihen nxënësit me projektin dhe mënyrën e organizimit të tij.
- Programohet organizimi i një ekspozite me përmbajtje shahun (vizatime, piktura, krijime me material të ricikluar etj.) Për këtë merret pëlqimi paraprak dhe

sigurohet bashkëpunimi me mësues të lëndëve të tjera (mund të përgatitet një kërcim ritmik me përmbajtje lëvizjet e gurëve të shahut). Ideohet në bashkëpunim me ta, forma dhe përmbajtja e aktivitetit. Krijohet grupi i punës mësues- nxënës, që do të merret me organizimin dhe zhvillimin e aktivitetit.

- Për të plotësuar kuadrin e aktivitetit, mund të merren kontakte me klubin sportiv apo federatën, për organizimin e një simultane më një shahist të shquar të zones (qytetit, vendit) me të cilin mund të luajnë njëkohësisht, mësues dhe prindër të shkollës.
- Përcaktohen periudhat kohore për organizimin dhe përmbushjen e detyrave të vecanta.

✓ **Burime**

- **Për organizimin e aktivitetit;** sigurohet përcaktimi i ambientit dhe vënia në dispozicion e tij, si dhe baza materiale e nevojshme. Sigurohet përgatitja e nxënësve për të zhvilluar lojra shahistike dinjitoze.
- **Në shkollë:** mësuesit kordinatorë të aktivitetit dhe mësuesit e tjerë të shkollës (informatika, matematika, aftësi teknologjike, vizatimi, letërsia, edukimi fizik, etj..)
- **Jashtë shkolle:** komuniteti i prindërve, klubi sportiv, specialistë shahu, etj.)

✓ **Zhvillimi**

1. Para aktivitetit

- Duhet të krijohen grupet e nxënësve që janë të interesuar.
- Paraprakisht janë marë të dhënat e duhura nga bashkëpunimi i mësuesit kordinator me drejtorinë e shkollës dhe mësuesit e lëndëve të tjera.
- Përgatitet platforma e organizimit të aktivitetit dhe përgatitet një tabelë me emrat dhe të dhënat e nxënësve të interesuar për të marë pjesë në garat sportive si dhe në aktivitetet e tjera plotësuese.
- Përcaktohen periudhat kohore dhe nxënësit përgjegjës për secilin nga aktivitetet.
- Punohet për sigurimin e bazës materiale të domosdoshme për garë dhe për aktivitete plotësuese.
- Programohet organizimi I garave sipas grup-moshave dhe klasave perkatëse.
- Përkujdesemi për të patur të ftuar nga drejtoria e shkolës, drejtues të DAR, drejtues të sportit në realitetin më të afërt (specialistë të shahut, klub, bashki, federatë etj..)
- Përcaktohet moderatori që do të njoftojë për publikun, nxënës të shkollës, prindër dhe të ftuar, ecurinë e aktivitetit

2. Gjatë aktivitetit

- Pasi organizohet konfigurimi i ambientit për zhvillimin e secilit prej aktiviteteve, garë sportive, simultane, ekspozitë dhe kërcim ritmik, realizohen kushtet për organizimin e garës
- Zhvillohen aktivitetet sipas programit paraprak.
- Garat shahistike, organizohen sipas grup-moshave dhe klasave te ndryshme

- Ndahen cmimet dhe trofe

3. Pas aktivitetit

- Pergatitet nje video- montazh me ecurine e aktivitetit, si pjese e historikut te aktiviteve te shkolles.
- Mbahet kontakt me specialistët e shahut, përgjegjës për shkollat, që do të konformohen nga bashkëpunimi I DAR me FSHSH.
- Zhvillimi i talenteve pranë klubeve apo shoqatave të shahut në realitetet e afërta (klube sportive, QKF etj.)

➤ **Pengesa dhe vështirësi**

Organizimi i nje aktiviteti te tille, kerkon angazhim dhe bashkepunim ne grup, planifikim si dhe pjesmarrje te gjere. Vecoria e lojes se shahut, kerkon pergatitje paraprake, si dhe njohje te aftesive te nxenesve. Per kalimin e veshtiresive te tilla, ndermeren takime te vecanta me nxenes te klasave te ndryshme dhe organizohen gara paraprake per te dalluar lojtaret me te mire. Per nje perfshirje sa me massive, si dhe per shperndarjen e detyrave, organizohen grupe pune dhe nxenesve qe nuk dine te luajne shah, u jepen detyra per organizimin e ekspozites, kryerrjen e kerkimeve mbi historikun, botimet shahistike, etj. Nje pjese e tyre mund te perfshihen ne aktivitet me detyra te vecanta, si foto, video etj.

➤ **Kontributi edukativ i projektit**

✓ **Zotërimi i aftesive organizative**

- Përzgjedhja e një grupi organizativ, me detyra specifike dhe nje planifikimi paraprak, u jep mundesine nxenesve te jene object dhe subject.
- Nxenesit e klasave me te larta, mund te kontribuojne si vullnetare ne organizimin e garave te klasave te ciklit te ulet.

✓ **Elementët e kulturës sportive**

- Nepermjet pjesmarrjes ne gara si dhe ne aktivitetet shoqeruese, nxenesit kane mundesine te perjetojne role te ndryshme, ate te sportistit perfaqesues, organizatorit, vullnetarit, etj
- Njohja me rregullat dhe rregulloren e lojes
- Me prezantimin e te ftuarve, u mundesohet marrja e njohurive te metejshme per organizatat sportive qe perfaqesojne sportin e shahut ne nivel qyteti dhe kombetar.

✓ **Kultura qytetare**

- Kyerja e kerkimeve për përdorimin e materialeve të ofruara nga biblioteke, mbi historinë e suksesshme të figurara të shquara në shah.
- Njohja e rregullave dhe rregulloreve, si pjese e organizatave sportive dhe cultures qytetare ne teresi.

✓ **Kompetenca sociale dhe qytetare**

- Përcaktimi dhe respektimi i rregullave të organizimit të aktivitetit dhe përlogaritja e veprimeve në kohën e duhur.
- Marrja e detyrave dhe kopetencave të ndryshme

➤ **Efekte të pritura në praktikën e aktiviteteve sportive shahistike**

- **Në një aktivitet të shkollës**

Njohja e aftësive personale të nxënësit në organizimin e një gare.

- ✓ **Njohuri**

- Mësimi i lëvizjeve të shahut, konceptet bazë të lojës, teknika dhe taktika, strategjitë për një lojë të mbyllur me sukses, aftësia për të parashikuar lëvizjet e mundshme të kundërshtarit.
- Përmirësimi i vetvetes nëpërmjet pjesëmarrjes në lojra dhe gara
- Të ndërtohet një plan stërvitor sipas një objektiivi e një pikësnyimi.
- Parimet e lojës së shahut, për të ndërtuar një projekt të përshtatshëm dhe të realizueshëm.

- ✓ **Aftësi**

- ✓ Diferencimi i fazave të veprimit

- ✓ Aplikimi i një plani pune.

- ✓ Ndërtimi, adaptimi dhe respektimi i një projekti në funksion të aftësive të nxënësve, moshës së tyre dhe kushteve të shkollës dhe ambientit rrethues

- ✓ **Sjellje**

- Të përgatitesh për një proces të mësuari të lojës së shahut
- Të bëhesh pjesë e një komuniteti sportiv
- Të pranosh ngarkesën e punës (studim dhe përsëritje).
- Të bashkëpunosh brenda grupit për të ndërtuar një projekt kolektiv, i cili mobilizon burimet më të mira.

➤ **Në mjedisin sportiv**

- Të njohësh parimet dhe metodat e stërvitjes, për t'i përdorur ato me efikasitet në një projekt të suksesshëm sportiv.
- Të përgatitesh dhe të marrësh pjesë në një garë konkurruese
- Të dallosh konceptet e suksesit personal, relativ, absolut.
- **Në jetën e përditshme**

- Të përqëndrohesh në rolin tënd, të jesh i kërkues, i përpiktë dhe i organizuar.

MODELE

III- Përgatitja e një projekti të përbashkët ndërlëndor

Propozime për mënyrën e implementimit të projektit në lëndë të ndryshme mësimore:

1- Matematike:

- Nderthurje e njohurive të ndryshme matematikore me levizjet e gureve të shahut
- Nderthurje e njohurive të matjes së kohës, me kohën e lojës etj..
- Fusha e shahut, forma e saj, rreshti, kolona, diagonalet etj

2- Gjuhe shqipe

- Emertimi i gureve të shahut dhe diferencimi nga kuptimi i mirefillte etj..
 - 3- Gjuhe e huaj: si në gjuhën shqipe
 - 4- Vizatim: vizatimi i fushës, gureve të shahut etj..
 - 5- Histori: Historia e lojës së shahut, sportit të shahut, figurave të shquara në shah, etj
 - 6- Gjeografi: shpërndarja gjeografike e vendeve që kanë futboll shahut në shkollë si lëndë mësimore
 - 7- Edukim fizik: rreshtimi në kolonë dhe rresht, imitimi i levizjes së gureve . koncepti Brenda, jashtë etj..
 - 8- Informatikë : nën kujdesjen e mësuesve që drejtojnë lëndën dhe duke u mbështetur në udhëzimet e dhëna nga ana e FSHSH, vizitojmë faqen e Fide Chess in School, opsionet e regjistrimit, bibliotekën e saj si dhe inkurajojmë nxënësit për t'u regjistruar në paketat e mesiperme. Në bashkëpunim me mësuesit e gjuhëve të huaja, përdorim opsionet në gjuhët e ndryshme të dhëna në faqen e Fide.
 - 9- Aftësi teknologjike:
 - Në kompiuter, zbulimi dhe përdorimi i link-ëve të ndryshme për mesazhet e shahut
 - Krijimi i një fushe shahu apo gure me mjete të ricikluar etj..
- E rëndësishme është që njohuritë të jepën të sakta dhe të thjeshta e në formë zbavitëse. Shahut në fund të fundit është një lojë që kushdo mund ta luajë në shkollë.

Propozimi ynë është që projekti të miratohet para fillimit të vitit mësimor dhe secili nga mësuesit e lëndëve të përfshira, të hartojë një program të vetin, i cili do të bashkërendohet me mësuesit e lëndëve të tjera, nën drejtimin e mësuesit kordinator, në një projekt të shkollës, të miratuar nga Drejtoria e shkollës.

Mësuesi kordinator, preferohet të jetë nga lëndë e matematikës apo informatikës, ndërsa për organizimin e grupeve të shkollës dhe aktiviteteve si dita/et e shahut, kampionatet e klasave apo ai i shkollave, do të duhet të përfshihen edhe mësuesit e edukimit fizik, si dhe persona dashamirës të shahut/anëtarë të komunitetit të prindërve dhe specialistë të shahut nga klubet apo FSHSH. ***Fjalët kyçe:Shahu në shkollë, aftësi, zotërim i kompetencës, aktivitet, projekt ndërkurrikular, planifikimi i projektit, planifikim i aktivitetit***